



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 3.1, 3.4, 15.1, pikat (a) dhe (c), dhe 21.2, 78, 79 dhe 80 pika (a) e Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Viti III, nr. 28, 4 qershor 2008),

Me qëllim të përcaktimit të kornizës ligjore për Hartat Aeronautike në përputhje me Standardet dhe Praktikat e Rekomanduara të parapara në aneksin 4 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik me të gjitha palët e interesuara në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

## **RREGULLORE NR. 9 /2014 MBI HARTAT AERONAUTIKE**

### **Neni 1**

#### **Fusha e zbatimit**

1.1 Kjo rregullore përcakton kërkesat e Hartave Aeronautike në pajtim me Standardet dhe Praktikat e Rekomanduara përkatëse (SPR-vë) të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ONAC), të përcaktuara në aneksin 4 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar.

1.2 Përgatitja e Hartat Hartave Aeronautike në Republikën e Kosovës, do të rregullohet nga SPR-të e aneksit 4, siç është publikuar në Edicionin e 11-të, korrik 2009 nga ONAC-i.

### **Neni 2**

#### **Zbatimi i SPR-ve**

2.1 Aneksi 4 mbi Hartat Aeronautike siç është përcaktuar në nenin 1 paragrafin 2 të kësaj rregulloreje, do të jetë i zbatueshëm në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

2.2 SPR-të e zbatueshme të specifikuara në Aneksin 4 dhe Shtojcat 1-6 do të jenë të zbatueshme në Republikën e Kosovës, përveç nëse dispozitat e nenit 4 të kësaj rregulloreje përcaktojnë ndryshe.

### **Neni 3** **Shprehjet dhe përkufizimet**

3.1 Për qëllim të kësaj rregulloreje termat “Shtet Kontraktues”, “Shteti”, “Autoritet përkatës” drejtpërdrejtë ose tërthorazi të përdorura në njëjës apo në shumës në Aneksin 6 në Konventën mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, siç është përcaktuar më sipër në nenin 1, paragrafin 2, do të lexohen si “Republika e Kosovës”.

3.2 Dallimet e listuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje në kuptim të kësaj rregulloreje nënkuptojnë qoftë shmangien nga standardi ose ngritjen e një praktike të rekomanduar në nivelin e standardit.

### **Neni 4** **Dallimet nga SPR-të**

4.1 Dallimet e zbatueshme nga SPR-të e Aneksit 4 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar siç është përcaktuar në nenin 1, paragrafin 2 të kësaj rregulloreje janë listuar sipas renditjes së mëposhtme:

1. Kapitulli 2, specifika të përgjithshme, neni 2.1 kërkesat operative për hartat, rekomandimet 2.1.7 dhe 2.1.8 do të zbatohen si Standard pa ndryshim në tekst;
2. Neni 2.4 Simbolet, Rekomandimi 2.4.5 do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;
3. Neni 2.11 Ngjyrat, Rekomandimi do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;
4. Neni 2.12 Relievi, Rekomandimi 2.12.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;
5. Neni 2.14 Shërbimet e Trafikut Ajror, Hapësirat Ajrore, Rekomandimi 2.14.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;
6. Neni 2.15 Variacioni Magnetik, Rekomandimi 2.15.2 dhe 2.15.3 do të zbatohen si Standard pa ndryshim në tekst;
7. Kapitulli 3, Harta e Pengesave të Aerodromit- Tipi A i ONAC-it, Neni 3.5 Format, Rekomandimi 3.5.3.1, do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;
8. Neni 3.8 të Dhënat Aeronautike, Rekomandimi 3.8.3.2, 3.8.4.1.1, do të zbatohen si Standard pa ndryshim në tekst;
9. Neni 3.9 Saktësia, Rekomandimi 3.9.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;

10. Kapitulli 4, Harta e Pengesave të Aerodromit- Tipi B i ONAC-it, Neni 4.2 Disponueshmëria, Rekomandimi 4.2.1 do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;
11. Neni 4.9 të Dhënat Aeronautike, Rekomandimi 4.9.1.1, 4.9.1.2 dhe 4.9.1.3 do të zbatohen si Standard pa ndryshim në tekst;
12. Neni 4.10 Saktësia, Rekomandimi 4.10.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;
13. Kapitulli 6, Harta e Terrenit për Qasje Precize -ONAC, Neni 6.3 Shkalla, Rekomandimi 6.3.1 do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;
14. Neni 6.5 Informatat e Planit dhe Profilit, Rekomandimi 6.5.2 dhe 6.5.3 do të zbatohen si Standard pa ndryshim në tekst;
15. Kapitulli 9, Harta Standarde e Shkuarjes -- Instrumenti (SID) – ONAC, Neni 9.4Projektimi, Rekomandimi 9.4.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;
16. Neni 9.6 Kultura dhe Topografia, Rekomandimi 9.6.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;
17. Kapitulli 10, Harta Standarde e Arritjes – Instrumenti (STAR) – ONAC, Neni 10.4 Projektimi, Rekomandimi 10.4.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;
18. Neni 10.6 Kultura dhe Topografia, Rekomandimi 10.6.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;
19. Kapitulli 11, Harta e Ardhjes me Instrumente - ONAC, Neni 11.3, Rekomandimi 11.3.3.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;
20. Neni 11.4 Format, Rekomandimi do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;
21. Neni 11.7, Kultura dhe Topografia, Rekomandimi 11.7.3 do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;
22. Neni 11.8 Variacioni Magnetik, Rekomandimi 11.8.1 do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;
23. Neni 11.10 të Dhënat Aeronautike, Rekomandimet 11.10.2.2, 11.10.2.4, 11.10.6.5, 11.10.8.3, 11.10.8.4 do të zbatohen si Standard pa ndryshim në tekst;
24. Kapitulli 13, Harta e Aerodromit/Heliportit - ONAC, Neni 13.2 Disponueshmëria, Rekomandimi 13.2.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;
25. Kapitulli 15, Harta e Ndaljes/Parkimit të Avionëve - ONAC, Neni 15.2 Disponueshmëria, Rekomandimi 15.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;
26. Neni 15.3 Mbulueshmëria dhe Shkalla, Rekomandimi 15.3.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;
27. Kapitulli 16, Harta Botërore e Aeronautikës - ONAC 1:1 000 000, Neni 16.4 Format, Rekomandimi 16.4.1 do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;

28. Neni 16, Kultura dhe Topografia, Rekomandimi 16.7.9.3 do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;
29. Kapitulli 17, Harta e Aeronautikës - ONAC 1: 1 500 000, Neni 17.2 Disponueshmëria, Rekomandimi do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;
30. Neni 17.7, Kultura dhe Topografia, Rekomandimet 17.7.4, 17.7.9.3 do të zbatohen si Standard pa ndryshim në tekst;
31. Kapitulli 20, Paraqitja Elektronike e Hartave Aeronautike - ONAC, Neni 20.2 Informacioni në dispozicion për paraqitje, Rekomandimi 20.2.2 do të zbatohet si Standard pa ndryshim në tekst;

4.2 Dallimet e paraqitura në paragrafin 1 të këtij neni, do të publikohen në Publikimin e Informatave Aeronautike (PIA), njëzet e tetë (28) ditë nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

### **Neni 5 Disponueshmëria**

Teksti i rishikuar i SPR-ve të Aneksit 4, siç është specifikuar në nenin 1, paragrafin 2, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, i është bashkëngjitur kësaj rregulloreje si Shtojca 1.

### **Neni 6 Dispozitat përfundimtare**

Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk do të mbizotërojnë mbi dispozitat e rregulloreve tjera të AAC-së që miratojnë standarde të avancuara ose më të strikte në fushën e mbuluar nga Aneksi 4 i Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar.

### **Neni 7 Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi më 29 nëntor 2014.

Prishtinë, 14 nëntor 2014.

**Dritan Gjonbalaj**  
Drejtor i Përgjithshëm